

Llukman Nebiu

ÇËSHTJE BAZË TË MUSLIMANIT

Shkup, 2023

Titulli:

Çështje bazë të Muslimanit

Autor:

Llukman Nebiu

Recensent:

Dr. Musli Vërbani

Realizimi dhe përgatitja kompjuterike:

Ridvan Vërbani

Realizimi dhe përgatitja kompjuterike:

Ridvan Vërbani

Në emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit!

ÇKA ËSHTË E DOMOSDOSHME NË BESIM

Të gjithë njerëzit duhet të hynë në fenë Islame.

Të gjithë njerëzit duhet që, vazhdimisht, pandërprerë dhe përgjithmonë t'i përmbahen dispozitave të sheriatit.

Duhet ditur, duhet besuar dhe duhet shprehur - nëse ka qenë pabesimtar - dy dëshmitë, e ato janë:

- **Dëshmia se nuk ka Zot pos Allahut.**
- **Dëshmia se Muhamedi është i dërguar i Allahut.**

KUPTIMI I DËSHMISË “NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT”

Fjalja: “**Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut**” nënkupton si në vijim:

Besojeni dhe dijeni se:

- Nuk ka të adhuruar dhe nuk meriton të adhurohet askush tjetër përveç Allahut, Një të Vetëm,

- I Përhershmi i pa fillim,

- Krijuesi,

- Furnizuesi,

- I Dituri,

- I Plotfuqishmi, i Cili vepron çka të Dëshiron.

- Çka Dëshiron Allahut bëhet, çka nuk Dëshiron nuk bëhet.

- Asgjë nuk mund të lëvizë dhe askush nuk mund të lëvizë dhe të ndryshon diç pos Allahut.

Allahu cilësohet me cilësitë e përsosura të cilat i takojnë vetëm Atij. I Cili është i pa të meta, është i përhershëm, i pa fillim, çdo gjë pos Tij është e krijuar dhe Ai është Krijues i atyre të krijuarave.

Çdo gjë bën pjesë në të krijuarat e Tij, si ato konkrete, ashtu edhe ato abstrakte, po ashtu edhe veprat janë të krijuara prej Tij, duke filluar që nga grimca e atomit e deri te Arshi i madh.

Pastaj, janë të krijuara edhe lëvizjet e njerëzve.

Pastaj, janë të krijuara edhe moslëvizjet e tyre.

Pastaj, janë të krijuara edhe qëllimet e tyre.

Pastaj, janë të krijuara edhe mendimet e tyre.

Të gjitha këto janë krijesa të Allahut. Nuk i ka krijuar askush tjetër pos Allahut. Të gjitha këto nuk kanë ardhur në ekzistencë vetvetiu dhe pa kurrfarë arsye.

Dituria e Zotit është e përhershme pa fillim.

Allahu me vullnetin e Tij ka krijuar gjithçka nga asgjëja. Argument për këtë është thënia e Allahut të Madhërishëm: **“(Allahu) ka krijuar çdo gjë”.**

Allahu i Madhërishëm thotë: **“A ka krijues tjetër pos Allahut?”**

Nesefiu ka thënë: Njeriu, kur i bie qelqit (xhamit) me gurë, dhe qelqi (xhami) thyhet atëherë:

- Goditja,
- Thyerja dhe
- E thyera,

që të gjitha janë të krijuara prej Allahut, ndërsa njeriu e përfiton atë që e vepron, ndërsa e krijuara është vetëm prej Allahut dhe e askujt tjetër. Allahu i Madhërishëm thotë: **“Për atë vepër merr atë çka e meriton dhe për veprën që e vepron, ngarkohet me atë që e vepron”.**

“Fjala” e Allahut, është e përhershme pa fillim sikurse të gjitha atributet tjera të Tij. Kjo ngase me cilësitë e Tij dallohen nga të gjitha krijesat.

Allahu i Madhërishëm dallohet me cilësitë e Tij, me atributet e Tij, dhe me veprimet e Tij.

Allahu është i Dëlrë nga ajo që të padrejtët me arrogancën e tyre i përshkruajnë si cilësi dhe attribute të cilat nuk i takojnë Atij.

Nga ajo që kemi përmendur mund të konkludojmë se janë katërmëdhjetë (14) attribute të Zotit të përmendura dhe të përsëritura në Kur'an, ose tekstualisht ose në kuptim të tekstit, e ato janë:

EL VUXHUDE	Ekziston
EL-VAHDANIJE	Është Një
EL KIDEM (EL-EZELIJE)	I Përhershëm pa fillim
EL-BEKA	I Përhershëm pa mbarim
KIJAMETU BI NEFSIHI	Ekziston nga Vetvetja e Tij
EL-KUDRETU	I Plotfuqishëm
EL-IRADETU	I Vullnetshëm
EL-ILMU	I Ditur
ES-SEMIË	Dëgjon
EL-BESIRE	Sheh
EL-HAJATE	I Gjallë
EL-KELAM	Flet
EL MUHALEFETU LIL-HAVADATHI	Ndryshon nga aksidencat (të krijuarat)
ET-TEKVINE	I jep formën krijesave

- Përderisa këto attribute janë të përmendura në shumë tekste të sheriatit, dijetarët për to kanë thënë se duhet ditur dhe duhet besuar.

- Përderisa Allahu është i Përhershëm pa fillim, atëherë edhe atributet e Tij janë të përhershme të pa fillim. Kjo, ngase atributi shkon paralelisht me ekzistencën e Allahut të përhershëm pa fillim.

KONCEPTI: DËSHMOJ SE MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUARI ALLAHUT

Fjala: **Dëshmoj se Muhamedi është i dërguar i Allahut:** ka kuptimin si në vijim:

E di, besoj dhe e pranoj se Muhamedi a.s., i biri i Abdullahut, i biri i Abdul Mutalibit, i biri i Hashimit, i biri i Abdul Menafit Kurejshit, është rob i Allahut dhe i dërguar i Allahut për gjithë njerëzimin.

Krahas kësaj, besoj se:

- Është lindur në Meke, peygamberia e tij ka filluar në Meke.

- Pastaj ka migruar në Medine dhe është varrosur në Medine.

Kjo nënkupton se, ai është i sinqertë në çdo gjë që ka informuar dhe çka ka kumtuar nga Allahu, e prej atyre informatave janë:

- Dënimi dhe begatia në varr.
- Parashtrimi i pyetjeve të melaqeve, të Munkërit dhe Nekirit.
- Ringjallja.
- Tubimi.
- Katakлизma.
- Llogaridhënia.
- Shpërblimi.
- Dënimi.
- Kandari (peshorja).
- Xhehenemi.
- Ura e siratit.

- Ujëvara (Havdi).
- Shefaati.
- Xheneti.

Të pamurit e Allahut në botën tjetër, me sy, por pa e ditur mënyrën, vendin, kahjen dhe jo siç shihet e krijuara.

Për jetën e përgjithmonshme në botën tjetër.

Besimi në melaqet e Zotit.

Besimi në librat e Tij.

Besimi në kaderin e Zotit, në të mirën dhe në të keqen.

Besimi se pejgamberi a.s. është vula e pejgamberëve.

Pejgamberi a.s. është vula e pejgamberëve dhe zotëria i gjithë bijve të Ademit.

Duhet besuar se, secili pejgamber prej pejgamberëve të Allahut duhet të cilësohet me cilësinë e:

- Sinqeritetit.
- Dëgjueshmërisë.
- Bartës i amanetit në mënyrë të përsosur, dhe
- Me mendje të mprehtë.

Është absurde që ata të jenë gënjeshtarë, tradhtarë, mashtrues, mendjelehtë, frikacakë.

Pejgamberët duhet të kenë vetëm cilësitë pozitive dhe nuk duhet të kenë asnjë cilësi negative e cila do të ndikonte në mospranimin e fjalëve të tyre.

Duhet besuar se ata janë të siguar nga pabesimi, nga mëkatet e mëdha, nga mëkatet e vogla, si para pejgamberisë së tyre, ashtu edhe pas pejgamberisë së tyre. Lejohet që të ndodhë ndonjë lëshim prej tyre, mirëpo menjëherë pason

vërejtja për ta, dhe ata pendohen, ashtu që nuk meritojnë ndëshkim për ato lëshime.

Muëxhizet janë: Mrekullitë mbinatyrore të pejgamberëve, janë të vërteta. Muëxhizet janë të mbinatyrshme.

Çështja e **Kerametit** dhe çështja e **Evlijasë** është e vërtetë, ndërsa kjo në të njëjtën kohë është mrekulli mbinatyrore, ku pejgamberi e paraqet **“kerametin”** e tij para ndonjërit prej umetit të tij.

- Pejgamberët janë më të vlefshëm se melaqet e dalluara.
- Melaqet e dalluara janë më të vlefshme se evlijatë dhe njerëzit në përgjithësi.
- Një pejgamber është më i vlefshëm se të gjithë evlijatë.
- Sehabiu më i vlefshëm është Ebu Bekri.
- Pastaj Omerul Faruki.
- Pastaj Othmani, me nofkën pronari i dy dritave.
- Pastaj Aliju Zoti qoftë i kënaqur me të.
- Pastaj dhjetë sehabet e përgëzuar me xhenet e ata janë:
 - Talha.
 - Zubejri.
 - Seadi.
 - Seidi.
 - Abdurr-Rrahman bin Aufi dhe
 - Ebu Abidete bin el Xherahi.
- Pastaj pjesëmarrësit e betejës në Bedër.
- Pastaj pjesëmarrësit e betejës në Uhud.
- Pastaj, besatuesit e besës “Ridvanë” në Hudejbije.

ÇDO MUSLIMAN DUHET TA RUAJ FENË E TIJ

Çdo musliman duhet ta ruaj fenë e tij, duhet ta mbrojë nga çdo gjë që e dëmton, nga çdo gjë që e zhvleftëson dhe e shkatërron.

Nëse nuk e ruan fenë e tij: ai veç ka tradhtuar (dezertuar) dhe është larguar nga feja, Zoti na ruajttë.

Neveviu dhe të tjerët kanë thënë: ***“Largimi nga feja është lloji më i keqi i pabesimit”*** që do të thotë: ***çështja më e shëmtuar.***

Në kohë të sodit, në lidhje me këtë çështje flitet butësisht. Disa flasin fjalë të cilat fjalë konsiderohen *dalje prej feje*, ndërsa nuk e llogaritin se është mëkat dhe çështje pabesimi. Kjo duke u bazuar në thënien e pejgamberit a.s.: ***“Njeriu flet ndonjë fjalë, ndërsa nuk është i vetëdijshëm se ajo fjalë ndikon që të hedhet në zjarr shtatëdhjetë pashë”.*** Që do të thotë: Shtatëdhjetë vite në thellësi të xhehenemit, e cila është posaçërisht për pabesimtarët.

Hadithin e ka transmetuar Tirmidhiu dhe e ka konsideruar se është hadithë i mirë.

Në të njëjtin kuptim ekziston edhe hadithi i transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

Ky hadithë është argument se, për të kaluar në pabesim nuk është kusht që personi në fjalë ta di se a ka kaluar në pabesim apo jo, dhe anasjelltas as për ta ditur se ka kaluar prej pabesimit në besim nëpërmjet shqiptimit të besimit.

Po ashtu, nuk është kusht moshidhërimi siç e ka sinjalizuar Neveviu. Duke treguar mendimin e katër medhhebeve Neveviu ka thënë: ***Nëse një njeri hidhërohet***

në djalin e tij, e pastaj i mëshon me të fortë dhe i thotë: “A je, apo nuk je musliman? Ai i thotë me qëllim: Jo!. Atëherë ai ka dalë nga feja.

Kuptimi: “me qëllim”, do të thotë e ka pasur atë qëllim para se ta thotë atë fjalë.

Largimi nga feja është shumëllojtësh: Siç e ka klasifikuar Neveviju dhe të tjerët nga shafiijtë, hanefijtë dhe të tjerët:

1. Largimi nga feja në Çështje të Besimit.

2. Largimi nga feja nëpërmjet veprimeve.

3. Largimi nga feja nëpërmjet fjalëve.

Që të gjitha këto i kanë nëndegët e tyre.

ÇËSHTJA E PARË: DYSHIMI NË BESIM

Prej dyshimeve të para është:

- Dyshimi në Allahun,
- Dyshimi në pejgamberin,
- Dyshimi Kur'anin,
- Dyshimi Ditën e gjykimit,
- Dyshimi në xhenetin,
- Dyshimi në xhehenemin,
- Dyshimi në shpërblim,
- Dyshimi në dënim,

e kështu me radhë, për të cilat dyshime janë pajtuar dijetarët.

Pastaj:

- Nëse beson se bota është e përhershme pa fillim,
- Nëse beson se bota ekziston vetvetiu, e pastaj nga përbërja e saj.
- Nëse beson se bota ekziston vetëm për nga përbërja e saj.
- Nëse e mohon një atribut prej attributeve të Zotit, për të cilat janë dakorduar dijetarët si f.v.: atributi i Diturisë.
- Nëse nuk Lartmadhëron çka duhet Lartmadhëruar.
- Nëse nuk e Lartmadhëron atë çka është e domosdoshme si f.v.: Lartmadhërimi nga çështja se Zoti ka formë dhe është trup.
- Nëse e lejon të ndaluarën, për të cilën janë dakorduar dijetarët, e që dihet se në fe ajo çështje është e

patjetërsueshme dhe nuk ka dyshim si f.v.: prostitucioni, homoseksualizmi, vrasja, uzurpimi.

- Nëse e ndalon të lejuarën, e cila dihet botërisht siç është f.v.: shitblerja dhe martesë.

- Nëse i mohon obligimet për të cilat janë pajtuar dijetarët si f.v.: pesë kohët e namazit, ose sexhdeja në namaz, zekatin, agjërimin, haxhin, abdesin.

- Nëse e bën obligim atë që Ixhmai nuk e ka bërë obligim.

- Nëse e mohon një ligj për të cilën janë pajtuar dijetarët (për të cilën është themeluar Ixhmai).

- Nëse insiston se në një të ardhme nuk do të beson.

- Nëse insiston se nuk do të beson në ndonjë çështje e cila përmendet, ose që dyshon në atë çështje e që nuk e di atë rrezik.

- Nëse e mohon se Ebu Bekri ka qenë shok i pejgamberit.

- Nëse e mohon ndonjë pejgamber, për të cilin dijetarët janë pajtuar se është pejgamber.

- Nëse e mohon një shkronjë të Kur'anit.

- Nëse e shton një shkronjë në Kur'an, të cilët dijetarët e mohojnë se ekziston ajo fjalë.

- Nëse e përgënjeshtrojnë ndonjë pejgamber.

ÇËSHITJA E DYTË: LARGIMI NGA FEJA NËPËRMJET VEPRIMEVE

Çështja e dytë, çështja në veprime si f.v.:

- Sexhdeja para idhujve.

- Sexhdeja ndaj Diellit.

- Sexhdeja ndaj Hënës.

- E kështu me radhë si f.v.: sexhdeja ndaj ndonjë krijese tjetër, në mënyrë adhurimi.

Sa i përket sexhdesë së përshëndetjes është e ndaluar në sheriatin tonë, ndërsa ka qenë e lejuar në sheriatin para nesh, tek pejgamberët para shariatit tonë si f.v.: sexhdeja e melaqeve për Ademin a.s., e cila ka qenë sexhde nderimi.

Sa i përket sexhdes për idhujt, diellin, hënën, është pabesim.

Po ashtu edhe sexhdeja e disa njerëzve të cilët e mësojnë magjinë djallëzore është pabesim.

ÇËSHTJA E TRETË: LARGIMI NGA FEJA ME FJALË

Çështja e tretë, çështja me fjalë, në kuadrin e saj ngërthen fjalë të shumta dhe të panumërta, e prej tyre:

- Kur muslimani thotë: O pabesimtar, o jehudi, o i krishterë, o i pafe, duke dashur të aludon në tjetrin se është pabesimtar, ose i krishterë, ose jehudi, ose është i pa fe, jo në mënyrën e përngjasimit.

- Të tallurit me një emër prej emrave të Allahut të Madhërishëm.

- Të tallurit me premtimet e Allahut.

- Të tallurit me kërcënimet e Allahut dhe me çështjet tjera të cilat i takojnë Allahut, të cilat janë të panjohura për ne.

- Nëse thuhet: “Po të më urdhëronte Zoti për “këtë” nuk do ta veproja”.

- Nëse thuhet: “Po të ishte kibla në këtë drejtim nuk do të falesha në atë drejtim”.

- Nëse thuhet: “Po të bëhej kibla në këtë drejtim nuk do të falesha në atë drejtim”.

- Nëse thuhet: “Po të më dhuronte Zoti xhenetin nuk do të hyja në të”. Kjo duke treguar kokëfortësi, apo duke shprehur arrogancë (krekosje).

- Nëse thuhet: Po të më dënonte Zoti për shkak të lënies së ndonjë namazi pa falë për shkak të sëmundjes, do të më bënte padrejtësi.

- Nëse thuhet: “Veprimet e kësaj ngjarjeje nuk janë të paracaktuara prej Allahut”.

- Nëse thuhet: “Nëse dëshmojnë për mua pejgamberët, nuk do ta pranoja dëshminë e tyre”.

- Nëse thuhet: “Nëse dëshmojnë për mua melaqet, nuk do ta pranoja dëshminë e tyre”.

- Nëse thuhet: “Nëse dëshmojnë për mua të gjithë muslimanët, nuk do ta pranoja dëshminë e tyre”.

- Nëse thuhet: “Nuk e veproj këtë veprim kështu, edhe në qoftë ai veprim sunet”, duke pasur për qëllim talljen.

- Nëse thuhet: “Nëse filani është pejgamber nuk e besoj atë se është pejgamber”.

- Nëse dijetari jep fetva dhe thotë: “Çka është ky ligj”, duke dashur ta poshtëron dispozitën sheriatike”.

- Nëse thotë: “Allahu mallkoftë çdo dijetarë”, duke dashur të përbaltë të gjithë dijetarët.

Ai i cili thotë: Allahu e mallkoftë çdo dijetarë, duke e përshkruar arsyen, e cila arsye tregon se nuk ka për qëllim gjeneralizimin (të gjithë dijetarët) si f.v.: ia përmend emrin atij ose ndonjë dijetari shkatërrimtar dhe thotë: “Allahu mallkoftë çdo dijetarë”, atëherë fjala nënkupton dijetarë të atij përshkrimi - atëherë nuk del nga feja.

Mirëpo nëse e thotë këtë fjalë: “Allahu e mallkoftë çdo dijetarë”, pa bashkangjitur arsyen, atëherë del prej feje. Vetëm qëllimi pa arsyetim nuk mund ta mbron atë që të del nga feja. Mirëpo, nëse nuk ka pasur për qëllim që t'i përfshinë të gjithë dijetarët, por ka pasur për qëllim mallkimin e dijetarëve të kohës së tij dhe ka pasur argumentim të arsytuar i cili dëshmon atë që ka thënë për

shkak të degjenerimit të tyre, atëherë ai nuk del prej feje, edhe pse nuk mund të shpëton nga mëkati.

RREGULL

Është rregull:

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me Allahun, ai e ka mohuar Zotin”.

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me librat e Tij, ai e ka mohuar Zotin”.

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me pejgamberët e Tij, ai e ka mohuar Zotin”.

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me melaqet e Tij, ai e ka mohuar Zotin”.

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me ligjet e Tij, ai e ka mohuar Zotin”.

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me simbolet e fesë së Tij, ai e ka mohuar Zotin”.

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me dispozitat ligjore të fesë së Tij, ai e ka mohuar Zotin”.

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me premtimet e Tij, ai e ka mohuar Zotin”.

“Çdo njeri i cili beson, ose vepron, ose thotë diçka që tallet me kërcënimet e Tij, ai e ka mohuar Zotin”.

Njeriu në çdo rast duhet të jetë i kujdesshëm në të gjitha këto të cilat i përmendëm.

AI I CILI LARGOHET NGA FEJA DUHET TË KTHEHET MENJËHERË NË ISLAM

Ai i cili largohet nga feja duhet menjëherë të kthehet në Islam duke shqiptuar dhe duke deklaruar shehadetin:

- Duhet të heq dorë nga largimi i fesë;
- Duhet të pendohet nga veprimi i tij, dhe
- Duhet të vendos që kurrë nuk do të kthehet në veprim të ngjashëm.

Posa të kalon në pabesim, i zhvleftësohet agjërimi i tij, tejemumi i tij.

Posa të kalon në pabesim i zhvleftësohet kurorëzimi (automatikisht ndodhë shkukurorëzimi) i tij para se të kontakton me të.

Po ashtu, pas largimit nga feja, nëse gruaja e tij është në IDET nuk lejohet të martohet me atë muslimane deri sa të kthehet në fe.

Ai i cili largohet nga feja, ndalohet kurban i prejtij (dhe mishi i kafshës së therur prej tij).

Nuk trashëgon.

Nuk trashëgohet.

Nuk i falet namazi.

Nuk i pastrohet kufoma.

Nuk mbulohet me kefin.

Nuk varroset në varrezat e muslimanëve.

Pasuria e tij dorëzohet në arkën qendrore (el-Fie).

NJERIU DUHET T'I KRYEJ TË GJITHA OBLIGIMET

Duhet t'i zbaton urdhrat e Allahut

Urdhrat e Allahut zbatohen duke i plotësuar parakushtet dhe kushtet e urdhëresave dhe duhet të largohet nga çdo gjë që zhvleftëson veprën.

- Nëse sheh dikë i cili nuk i zbaton urdhrat, ose i cili nuk i kryen në formën e duhur, nëse ka mundësi e detyron ta zbaton atë urdhër.

- Nëse sheh dikë i cili nuk i kryen në formën e duhur, nëse ka mundësi atëherë duhet ta detyron ta kryen në formën e duhur.

- Nëse nuk ka mundësi ta detyron t'i zbaton urdhrat, atëherë e urren atë veprim, por ky është besimi më i dobët. Pra, minimumi të cilën duhet ta veproj njeriu kur nuk ka mundësi është të urreyerit e asaj çështje.

Duhet të largohet nga të gjitha ndalesa

Nëse sheh ndonjërin i cili vepron ndalesat, e ndalon me forcë nëse ekziston mundësia, në të kundërtën duhet ta urrej me zemër atë veprim.

Haramë: llogaritet vepra për të cilën Allahu ka paralajmëruar se dënon, ndërsa për atë i cili largohet nga ai veprim, ka premtuar se shpërblen.

E kundërta e të vepruarit haram është **vaxhibi (obligueshmëria)**.

DETYRAT E ZEMRËS

Prej detyrave të zemrës:

Besimi në Zotin dhe çka ka ardhur prej Zotit.

Besimi në pejgamberët e Zotit dhe në atë çka ka ardhur nga pejgamberët e Zotit.

Sinqeriteti - Sinqeritet quhet vepra e cila bëhet vetëm për Allah.

Pendimi nga mëkatet.

Mbështetja në Allahun.

Bindja se Allahu sheh çdo gjë dhe monitoron çdo gjë.

Të kënaqurit me Zotin, që nënkupton të dorëzuarit në Zotin dhe moskundërshtimi në caktimin e Zotit.

Nderimi dhe respektimi i ligjeve të Allahut.

Falënderimi për të mirat e Allahut, që nënkupton mosshfrytëzimi i të mirave në mëkate.

Durimi në kryerjen e urdhreve të Zotit.

Durimi në mos kryerjen e çështjeve të cilat i ka ndaluar Zoti.

Durimi në sprova dhe në fatkeqësi.

Të urreyerit e Shejtanit.

Refuzimin e mëkateve.

Dashuria ndaj Allahut.

Dashuria ndaj fjalës së Tij.

Dashuria ndaj të dërguarit.

Dashuria ndaj sehaveve.

Dashuria ndaj familjes së pejgamberit dhe ndaj njerëzve të mirë.

MËKATET E ZEMRËS

Prej mëkateve të zemrës:

- Syfaqësia dhe proklamimi i veprave të mira. Ajo vepër është vepër për njerëzit, pra, vepron që të jetë i lavdëruar prej njerëzve, ndërsa nuk e di se e humb shpërblimin e asaj veprë.

Vetpëlqimi në kryerjen e urdhrave ndaj Allahut, pra, duke treguar adhurimin të cilin njeriu e kryen në vetmi, pastaj lavdërohet para tjerëve.

Dyshimi në Allahun.

Mendjemadhësia para njerëzve, duke mos ia pranuar fjalën e drejtë tjetrit dhe nënçmimin e njerëzve.

Urrejtja, duke e fshehur armiqësinë.

Zilia, urrejtja ndaj të mirës që ka muslimani.

Xhelozia: Kur e urren begatinë te muslimani, i vjen keq dhe vepron kundër tij.

Proklamimi i sadakasë, e zhvleftëson shpërblimin si f.v.: Atij të cilit i ke dhënë sadaka (lëmoshë) t'i thuash: "A nuk të kam dhënë kaq (para) në këtë ditë?".

Insistimi në mëkate.

Mendimi negativ për Allahun dhe për robërit e Allahut.

Dëfrimi me mëkatin e vet.

Dëfrimi me mëkatin e tjetrit.

Tradhtia, qoftë edhe ndaj pabesimtarit si f.v.: i siguron garancë (i jep besë), pastaj e vret.

Lajkatimi.

Urrejtja ndaj sehaveve, familjeve të tyre dhe të mirëve.

Koprracia ndaj obligimeve ndaj Allahut.

Koprracia ndaj simboleve të Allahut dhe mosvlerësimi i devotshmërisë, indiferenca ndaj mëkateve, ndaj Kur'anit, ndaj ditorisë, ndaj xhenetit, ndaj xhehenemit.

MËKATET E BARKUT

Nga mëkatet e barkut:

Ushqimi nga kamata.

Ushqimi nga uzurpimi.

Ushqimi nga vjedhja.

Ushqimi nga çdo veprimtari të cilën e ka ndaluar sheriat.

Pirja e alkoolit - Dënimi për këtë parashihet të jetë dyzetë shkopinj për të lirin, ndërsa njëzet shkopinj për të robëruarin.

Qeveritari mund të parasheh edhe më shumë, nëse veç duhet të jetë si masë parandaluese efektive për alkoolistin.

Përdorimi i çdo lloj lënde dehëse.

Ndalohet çdo lloj pije apo ushqimi i fëlliqu.

Shfrytëzimi (keqpërdorimi) i pasurisë së jetimit.

Shfrytëzimi (keqpërdorimi) i vakëfit në mënyrë të kundërt për të cilën e ka parapa trashëgimtari (vakëflënësi).

Të pronësuarit e ndonjë prone publike me qëllim të keq, jo për ta ngjallë atë pronë por për ta bllokuar, e për të mos e shfrytëzuar.

MËKATET E SYRIT

Prej mëkateve të syrit:

Shikimi në gratë e huaja në pjesën e fytyrës dhe duarve, por edhe në pjesët tjera.

Po ashtu edhe nëse gratë shikojnë burrat në pjesët e këmbëve nën gjunjë dhe në pjesët e trupit mbi kërthizë.

Shikimi i pjesëve të turpshme të trupit (të të tjerëve).

Ndalohet edhe për burrin edhe për gruan që t'i shpalosin pjesët e turpshme të trupit pa nevojë qoftë edhe në vetmi.

Lejohet para mahremit apo para gjinisë së njëjtë shikimi mbi pjesën e kërthizës dhe nën gjunjë nëse shikohet pa epsh.

Ndalohet të shikohet muslimani me syrin (shikimin) e nënçmimit dhe të poshtërimit.

Ndalohet të shikohet në brendi të shtëpisë së tjetrit pa lejen e tij.

Ndalohet të shikohet diçka që ai e mban të fshehur.

MËKATET E GJUHËS

Nga mëkatet e gjuhës:

Përgojimi: Të përmendurit për vëllanë atë që ai e urren, sidomos në çështje të fizionomisë së tij.

Shpifja: bartja e fjalëve për të shkatërruar dhe për të dëmtuar tjetrin.

Ngacmimi me fjalë ofenduese.

Gënjeshtria: të folurit e së kundërtës me atë që është reale.

Betimi rrejshëm.

Akuzimet e pabazuara: Këtu bëjnë pjesë shumë çështje dhe shumë fjali të cilat njeriu i përdorë e të cilat fjalë kanë nënkuptimin e prostitucionit. Pra janë fjalë të cilat e paraqesin haptazi (me fjalë konkrete) akuzimin për prostitucion, ose

janë fjalë në mënyrë alegorike të cilat kanë për qëllim akuzimin e tjetrit për prostitucion.

Ndëshkimi për akuzim për prostitucion është i paraparë si në vijim:

- *për të lirin (i cili nuk është rob) parashihet dënimi prej 80 shkopinje.*

- *për robin (i cili nuk është i lirë) parashihet dënimi prej 40 shkopinje.*

Ofendimi (sharja) i sehaveve.

Dëshmia rrejshëm.

Vonimi i afatit të borxhit për të pasurin.

Sharja dhe mallkimi.

Tallja me muslimanin, dhe çdo fjalë e cila e lëndon muslimanin.

Gënjeshtër për Allahun dhe për të dërguarin e Tij.

Akuzimi i pabazuar.

Shkurorëzimi bid'at: Kur thuhet fjala e shkurorëzimit gjatë kohës kur gruaja është me menstruacion, ose kur ajo nuk është në ciklin e menstruacionit me të cilën ka kontaktuar.

Fjala e **“Dhiharit”**: Atëherë kur njeriu i thotë bashkëshortes se ajo është sikurse nëna e tij pra, duke aluduar në atë se nuk do të kontakton intimisht me të.

Gabimi në lexim të Kur'anit, i cili lexim i jep kuptim tjetër fjalisë.

Leximi gabim, i cili gabim është gabim gramatikor edhe nëse nuk është gabim i kuptimit të fjalës.

Betimi për të dhënë diçka me qëllim që të privojë trashëgimtarin nga trashëgimia.

Lënien e borxhit testament.

Lënien e diçkaje (ndonjë sendi) testament pa e ditur askush.

Kur njeriu deklaron se nuk është djali i babës së tij, apo se është i liruar nga zotëria i tij, si f.v.: thotë: Unë e kam liruar filanin, në fakt nuk e ka liruar atë rob.

Fejesa me të fejuarën e vëllait (për nga feja).

Dhënia e fetvasë pa dituri.

Të mësuarit e mësimit të dëmshëm, pa ndonjë arsye të shariatit.

Gjykimi jo me ligj të Allahut.

Vajtimi.

Çdo fjalë e cila nxit haramin.

Çdo fjalë e cila largon nga vaxhibi.

Çdo fjalë e cila e akuzon fenë.

Çdo fjalë e cila akuzon ndonjë pejgamber ose dijetar.

Çdo fjalë e cila akuzon Kur'anin, ose ndonjë ligj Islam.

Fabrikimi i gënjeshtreve.

Heshtja: mosurdhërimi në punë të mira dhe mosndalimi nga punët e këqija pa ndonjë arsyetim paraprak.

Të fshehurit e diturisë obligative atëherë kur ajo dituri kërkohet.

Të qeshurit me zë për të nxjerrë erë të keqe.

Të qeshurit me zë për ta poshtëruar muslimanin.

Fshehja e dëshmisë.

Moskthimi i përshëndetjes së selamit vaxhib.

Ndalohet puthja me epsh e Haxhiut (gjatë Haxhit).

Ndalohet puthja me epsh e atij i cili është në Umre.

Ndalohet puthja e agjëruesit (të agjërimit farz), nëse frikësohet se ejakulon. Ka mendime se është mekruh.

Po ashtu ndalohet puthja e asaj e cila është e ndaluar.

MËKATET E VESHËVE

Prej mëkateve të veshëve:

Dëgjimi i fjalëve të tjerëve në fshehtësi.

Dëgjimi i instrumenteve muzikore dhe i vargjeve të ndaluara.

Dëgjimi i përgojimeve.

Dëgjimi i nënçmimeve.

Dëgjimi i përqeshjeve e të ngjashme.

Nëse këto dëgjohen me pa dëshirë, me presion, në këto raste duhet shmangur dhe duhet urryer në bazë të mundësive.

MËKATET E DUARVE

Prej mëkateve të duarve:

Mashtrimi në matje dhe peshojë.

Vjedhja: Për vjedhje dënohet ai i cili vjedh diçka mbi vlerën e çerekut ($1/4$) të dinarit. Dënimi i paraparë është prerja e dorës së djathtë, nëse i njëjti vjedhë përsëri i pritet këmba e majtë, nëse i njëjti vjedhë përsëri i pritet dora e majtë, nëse i njëjti i vjedhë përsëri i pritet këmba e djathtë.

Uzurpimi i pronave.

Grabitja e sendeve.

Ndryshimi dhe keqpërdorimi i pronave.

Mashtrimi dhe keqpërdorimi i pasurisë shtetërore.

Keqpërdorimi dhe keqtrajtimi i pasurisë së tjerëve.

Vrasja. Për vrasje bëhet kompensimi (KEFARETI).

Me i ra tjetrit me pa të drejtë.

Marrja dhe dhënia e mitos (ryshfetit).

Loja me lloje të ndryshme të kumarit, saqë edhe loja e fëmijëve me gazoza e sende të ngjashme është mëkat.

Lojërat me mjete muzikore të ndaluara si fjala ven: Taburi, Rubabi, mizmari dhe evtarë.

Të prekurit me qëllim të ndonjë gruaje në pjesën e pambuluar, ose me epsh, qoftë edhe në mes gjinisë së njëjtë.

Të prekurit me qëllim ndonjë femër me të cilën ndalohet martesë me të.

Fotografimi i frymorëve (krijesa me frymë).

Pengimi i zekatit, ose të një pjese të zekatit, pas obligueshmërisë dhe pas definimit të dhënies se çka nuk lejohet, ose dhënia atij i cili nuk e meriton.

Mosdhënia e pagës së punëtorit.

Mosdhënia e ndihmës dhe mosshpëtimi i të fundosurit në ujë.

Të shkruarit e asaj çka është e ndaluar të thuhet.

Tradhtia: e kundërta e këshillës. Këtu bëjnë pjesë fjalët, veprat dhe mënyra e tradhtisë.

MËKATET E ORGANEVE INTIME

Prej mëkateve intime:

Prostitucioni:

- I martuari, qoftë mashkull apo femër dënohet me gurëzim (të gurëve mesatar) deri në vdekje.
 - I pamartuari, nëse është i lirë dënohet me njëqind shkopinj, nëse është rob me pesëdhjetë shkopinj.
 - Homoseksualizmi.
 - Kontakti intim me kafshë.
 - Ejakulimi nga dora e cila nuk është dorë e gruas, ose nga dora e robëreshës me të cilën lejohet të kontakton.
 - Kontakti intim gjatë kohës së menstruacionit.
 - Kontakti intim pas skadimit të menstruacionit deri te pastrimi nga menstruacioni.
 - Kontakti intim gjatë kohës së lehonisë.
 - Kontakti intim pas skadimit të afatit të lehonisë deri te pastrimi nga lehonja.
 - Zbulimi i trupit para atij i cili nuk lejohet ta shikon trupin e zbuluar.
 - Zbulimi i trupit në vetmi pa ndonjë arsyë.
 - Kryerja e nevojës së vogël para Qabës pa pasur ndonjë perde (pengesë, mur, etj.) në mes tij dhe Qabës
 - Kryerja e nevojës së madhe para Qabës pa pasur ndonjë perde (pengesë, mur, etj.) në mes tij dhe Qabës.
- Perdja (pengesa) duhet të jetë e ngritur tre kuti e më shumë ose nëse nuk ka perde (pengesë) duhet të jetë larg tre kuti e më shumë.

- Nëse ka vend të caktuar për kryerje të nevojës, (WC) lejohet kryerja e nevojës së vogël në drejtim të Qabës.

- Nëse ka vend të caktuar për kryerje të nevojës (WC) lejohet kryerja e nevojës së madhe duke e kthyer shpinën në drejtim të Qabës.

- Kryerja e nevojës së vogël ose nevojës së madhe mbi varr.

- Urinimi në Mesxhid (Xhami) qoftë edhe nëse urinohet në ndonjë enë, si dhe urinimi në ndonjë vend të shenjtë.

MËKATET E KËMBËVE

Prej mëkateve të këmbëve:

- Shkuarja për të bërë mëkat, si f.v.: për të penguar muslimanin nga diçka, që do të thotë: Ecja për ta dëmtuar, pra shkon te qeveritari për ta lajmëruar për diçka e cila do ta dëmtonte muslimanin, e kështu me radhë.

- Ecja, për ta vrarë, që do të thotë, të ecurit për ta vrarë muslimanin me pa të drejtë.

- Ecja për ta dëmtuar muslimanin me pa të drejtë.

- Keqtrajtimi ndaj robit.

- Keqtrajtimi ndaj gruas.

- Keqtrajtimi ndaj atyre të cilëve ka të drejtë si f.v.: Kur e ka të drejtën e kërimit të drejtës së hakmarrjes.

- Neglizhimi në dhënien e borxhit.

- Keqmenaxhimi në shpenzimin ndaj të tjerëve.

- Vonimi në dhënien e DIJËS.

- Veprimi jo i drejtë në edukimin e fëmijëve.

- Ecja me kryelartësi dhe arrogancë.

- Shkelja në qafë.

- Ecja para falësit, atëherë kur falësi i namazit i ka plotësuar kushtet e SUTRES (pengesës).

- Zgjatja e këmbëve paralel me Mus'hafin, pos nëse Mus'hafi është në ndonjë lartësi.

- Çdo ecje udhëtimi për të vepruar ndonjë haram.

- Çdo ecje udhëtimi për t'u larguar nga kryerja e ndonjë obligimi.

MËKATET E TRUPIT

Prej mëkateve të trupit:

- Keqtrajtimi ndaj prindërve.

- **Ikja nga fronti:** Atëherë kur ndodhë ballafaqimi me armikun në betejën në rrugë të Allahut dhe bëhet largimi nga vija e frontit.

- Ndërprerja e lidhjeve farefisnore.

- Ofendimi i fqinjit, qoftë edhe pabesimtar. Kjo ngase ai ka siguri.

- Përngjasimi i burrave me gra dhe anasjelltas. Pra në çështje të cilat janë specifike e ndonjërës gjini, si në veshje të rrobave, ashtu edhe në çështje tjera.

- Lëshimi i rrobave të gjata në formë kryelartësie, pra lëshimi më poshtë se zogu i këmbëve për të treguar kryelartësi.

- Ndërprerja e farzit pa ndonjë arsyetim.

- Ndërprerja e punëve vullnetare pas ligjësimit të tyre.

- Ironizimi dhe tallja me besimtarin.

- Përvjedhja për t'i zbuluar pjesët intime të njerëzve.

- Nënçmimi dhe përqeshja e besimtarit.

- Tatuazhimi i trupit.

- Ndërprerja e raporteve me muslimanin në më shumë se tri ditë, përpos me të drejtë shariatike dhe me arsyetim shariatik.

- Shoqërimi me atë i cili bën bid'at, ose me mëkatarin, në mënyrë të pajtimit me mëkatin e tij.

- Përdorimi (veshja) me ari, me argjend dhe me rroba të mëndafshit. Për të moshërriturin lejohet vetëm unaza e argjendit.

- Të vetmuarit me të huajën, ashtu që nuk i sheh i treti, qoftë femër apo mashkull.

- Udhëtimi i gruas e pa shoqëruar me kujdestarë (me të cilin është e ndaluar të martohet).

- Ngjyrimi i trupit me ngjyrë të zezë.

- Sulmi ndaj udhëheqësit.

- Mbështetja e mëkateve.

-Përdorimi i enëve të arit dhe të argjendit.

- Mosveprimi i farzeve, ose të vepruarit e farzit duke mos e vepruar një kusht apo ndonjë parakusht të farzit, ose të vepruarit e farzit, por duke ia bashkangjitur një vepër e cila e zhvleftëson atë farz.

- Mosfalja e namazit të xhumasë dhe moskryerja e vaxhibeve të saj, edhe nëse personi në fjalë e falë drekën.

- Vonimin e farzit nga koha e vet pa ndonjë arsyetim.

- Gjuetia me elemente të forta, dhe të rënda, si f.v.: me gurë të rëndë dhe të mëdhenj (jo të mprehtë).

- Të marrurit e kafshëve (qenve, etj.) si hobi.

- Nëse nuk i sigurohet vendbanimi gruas së shkurorëzuar gjatë afatit të pritjes “IDETIT” pa ndonjë arsyetim.

- Gruaja e cila është në afatin e pritjes dhe gruaja së cilës i vdes burri, nëse nuk i përmbahet rregullit të mbajtjes zi (afatit të pritjes).

- Përdhosja e xhamisë, qoftë edhe me elemente të pastërtisë, ose vendosja në to elemente të fëlliqura.

- Neglizhimi për të shkuar në Haxh deri në vdekje, kur ka mundësi ta kryen Haxhin.

- Ai i cili merr borxh dhe e di se nuk mund ta lajë atë borxh, ndërsa borxhdhënësi nuk e di qëllimin e borxhmarrësit.

- Mosdhënia e një afati tjetër njeriut në gjendje të vështirë.

- Shpenzimi i pasurisë në mëkate.

- Shtyrja e mexhës, pra ndryshimi i kufirit të pronës tënde në dëm të tjetrit.

- Keqpërdorimi i pronës publike.

- Keqpërdorimi i sendit të huazuar, ose vonimi i afatit të sendit të huazuar.

- Moslejimin e të lejuarës si f.v.: vendet për kullotje.

- Moslejimin e shfrytëzimit të sendeve të lira në natyrë si f.v.: kripën, xehet, e elementet tjera të ngjashme.

- Moslejimin e shfrytëzimit të ujit të lirë në natyrë.

- Shfrytëzimi i sendit të humbur, para se t'i mëson kushtet.

- Ulja në vende të caktuara për të shikuar çështje të urryera, vetëm nëse ka arsyetim lejohet.

- Shkuarja në aheng i pandërgjegjshëm. Pra hyrja pa leje. Në aheng duhet të shkohet në mënyrë të drejtë, me kujdes dhe me ndërgjegje.

- Mosshpenzimi i drejtë në mes grave dhe mosndarja e drejtë e qëndrimit me to. Përderisa prioriteti ndaj ndonjërës me ndjenja të zemrës dhe të shpirtit dhe animi ndaj ndonjërës prej tyre nuk është mëkat.

- Dalja e gruas para burrave për ta ekspozuar veten e saj.
 - Magjia.
 - Dalja nga dëgjueshmëria ndaj Imamit (Udhëheqësit Islam) siç ka qenë rasti me ata të cilët kanë dalë nga radhët e Aliut, e pastaj edhe e kanë mbytur.
- Bejhekiu ka thënë: ***“Të gjithë pjesëmarrësit në vrasjen e Aliut janë kriminelë”***. I këtij mendimi ka qenë edhe Shafiiu para tij.
- Marrja përsipër e përgjegjësisë ndaj jetimit pa qenë i përgatitur për ta mbajtur atë përgjegjësi.
 - Marrja përsipër e përgjegjësisë për xhaminë pa pasur njohuri paraprake dhe pa qenë i përgatitur për ta mbajtur atë përgjegjësi.
 - Marrja përsipër çështjen e gjykimit, ose diçka të ngjashme pa pasur njohuri paraprake, ose pa qenë i përgatitur për ta mbajtur atë përgjegjësi.
 - Strehimin dhe sigurimin e kriminelit dhe moslejimin që tjetri të hakmerret ndaj kriminelit.
 - Qëndrimi në rrugë për t’i plaçkitur udhëtarët:
Dënohet, varësisht prej llojit të krimit:
 - *Ose duke i tërheq vërejtje dhe me dënim të kundërvajtjes.*
 - *Ose duke i prerë dorën dhe këmbën nëse nuk ka shkaktuar vrasje.*
 - *Ose duke e ekzekutuar dhe duke e lidhur në vend publik nëse vret.*
 - Mosplotësimin e betimit.
 - Agjërim 48 orësh. Pra duke agjëruar dy ditë e më shumë pa ngrënë dhe pa pirë.

- Zërja e vendit të tjetrit.
- Lëndimi i tjetrit në turmë duke e shtyrë.
- Zhvendosjen e tjetrit nga vendi i vet.

PENDIMI

I ngarkuari duhet të pendohet në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.

Pendim quhet kërkimfalja dhe heqja dorë nga mëkati me qëllimin për të mos u kthyer në atë mëkat.

Nëse mëkati ka të bëjë me lënien e ndonjë farzi, e kompenson (e bënë kaza).

Nëse mëkati ka të bëjë ndaj ndonjë njeriu, ia kompenson ose bën marrëveshje të pajtimit.

Subhane Rabike

Rabbil Izzeti

Amma jesifunë

Ve selamun alel murselinë

Velhamdulilahi Rabbil Aleminë.

I Lartësuar është Zoti yt,

Zot i fuqisë nga ajo që ia përshkruajnë.

Paqja qoftë mbi të dërguarit.

Dhe falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Përmbajtja:

ÇKA ËSHTË E DOMOSDOSHME NË BESIM	5
KUPTIMI I DËSHMISË “NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT”	6
KONCEPTI: DËSHMOJ SE MUHAMEDI ËSHTË I DËRGUARI ALLAHUT	9
ÇDO MUSLIMAN DUHET TA RUAJ FENË E TIJ	12
ÇËSHITJA E PARË: DYSHIMI NË BESIM	14
ÇËSHITJA E DYTË: LARGIMI NGA FEJA NËPËRMJET VEPRIMEVE	16
ÇËSHITJA E TRETË: LARGIMI NGA FEJA ME FJALË	17
AI I CILI LARGOHET NGA FEJA DUHET TË KTHEHET MENJËHERË NË ISLAM	20
NJERIU DUHET T’I KRYEJ TË GJITHA OBLIGIMET	21
DETYRAT E ZEMRËS	22
MËKATET E ZEMRËS	24
MËKATET E BARKUT	26
MËKATET E SYRIT	27
MËKATET E GJUHËS	28
MËKATET E VESHËVE	31
MËKATET E DUARVE	32
MËKATET E ORGANEVE INTIME	34
MËKATET E KËMBËVE	36
MËKATET E TRUPIT	37
PENDIMI	42

